

MBROJTJA E ULQINIT

Ulqini është qytet i lashtë ilir i fisit të labeatëve me emrin Ulcinium ose Olcinium. Përmendet për herë të parë në vitin 168 p.e.s. Kur e pushtuan romakët, ishte një nga limanët më të mbrojtur ku strehohej flota e fuqishme detare e shtetit ilir.¹ Ky qytet-port, aq i lakmuar nga të huajt për pozitën e tij të rëndësishme strategjike detare, u bë objekt pushtimesh në vazhden e historisë, nga romakët, bizantinët, venedikasit, serbët, osmanët, malazezët² e aleatët e tyre. Fuqitë e Mëdha e shqitën me dhunë nga trungu i truallit shqiptar dhe ia aneksuan Malit të Zi. Pikërisht për këtë padrejtësi të madhe historike të nëntorit 1880, e cila u pasua më 1913 me copëtimin masiv të tokave shqiptare, ne shqiptarët kudo që jemi, brenda dhe jashtë kufijve administrativë të shtetit të sotëm shqiptar, revoltohemi për atë gjëmë që na bënë asokohe fuqitë europiane, për të kënaqur lakmitë e shfrenuara të vendeve fqinje.

Sivjet mbushen 126 vjet nga ajo vjeshtë ogurzezë e shkëputjes me dhunë të Ulqinit. Edhe pse u nda administrativisht nga trojet shqiptare, Ulqini dhe ulqinakët e kanë ndier veten gjithmonë pranë tyre dhe kanë dhënë ndihmesa të shquara për çështjen kombëtare në të gjitha kohërat, duke nxjerrë burra të penës dhe të pushkës, që nga Ali Ulqinaku, Mehmet Gjyli, Mehmet Beci, Mujo Ulqinaku e deri tek brezat e sotëm.

Sipas vendimit të Fuqive të Mëdha të 26 qershorit 1880, Ulqini me rrethinat e tij duhej t'i dorëzohej Malit të Zi. Qeveria e Stambollit, edhe pse u gjend përballë qëndresës së vendosur të banorëve të Ulqinit dhe të të gjitha krahinave shqiptare, u detyrua të pranonte dorëzimin e Ulqinit, me qëllim që të mos zbatohet plani i demonstrimit detar, çka do të kishte pasoja për të. Ajo u mjaftua vetëm me disa ndryshime të vogla nga Fuqitë e Mëdha, siç janë mosdorëzimi i fshatit Dinosh të Grudës të Malit të Zi dhe zgjatja e afatit të dorëzimit të Ulqinit deri me 20 shtator 1880, nga tri javë që ishin përcaktuar në vendimin e qershorit. Stambolli llogariste se për zbatimin e këtij vendimi do të gjente mbështetjen e atyre personaliteteve shqiptare të cilat

mendonin se disfata e Ulqinit do të kopromentonte mbrojtjen e Camërisë dhe çështjen e të drejtave të autonomisë së Shqipërisë. Në fakt, tezën e Portës së Lartë e përqaftuan shumë krerë të moderuar të vendit, si Hodo Sokoli etj. Kjo shkaktoi përçarjen në radhët e udhëheqësve të Lidhjes Shqiptare, por atdhetarët e tjerë u përpoqën ta ndalnin zhvillimin e mëtejshëm. Vëmendja e opinionit publik tashmë u përqëndrua rreth zhvillimit dramatik të çështjes së Ulqinit.³

Ndërsa Porta e Lartë filloi të përgatitej intensivisht për të marrë masa energjike ndaj shqiptarëve tejet të revoltuar, degët e Lidhjes Shqiptare të Ulqinit dhe Shkodrës morën kundërmasa të ngutshme për organizimin e qëndresës ndaj vendimit të Fuqive të Mëdha dhe kundër kërcënimit të qeverisë së Stambollit. Kështu, në muajin gusht 1880, rreth 2000 vullnetarë shqiptarë të qytetit dhe të rrethit të Ulqinit rrëmbyen armët. Më vonë, pasi u mor vesh se flota detare e bashkuar e Fuqive Mëdha do të demonstronte në ujërat e Ulqinit, 6000 vullnetarë shqiptarë sulmuan më 17 shtator 1880 dhe morën në duart e tyre Ulqinin, duke e detyruar ushtrinë osmane të mbyllej në kazerma dhe më vonë të largohej fshehurazi nga qyteti.

Më 24 tetor 1880 në Shkodër u përhap fjala se Stambolli po dërgonte ushtri të shumta për të shtypur me dhunë qëndresën shqiptare të Ulqinit. Po atë ditë Komiteti i Lidhjes Shqiptare në Ulqin u dërgoi Fuqive të Mëdha një protestë të re ku shprehte se të gjithë banorët kishin lidhur besën për t'u mbrojtur dhe për të luftuar.⁴ Nga ana e vet, Komiteti i Shkodrës, përveç masave të gatishmërisë që mori në Ulqin, po atë ditë nisi për në qytet vullnetarë të rinj, duke i treguar kështu administratës shtetërore se ishin të vendosur për ta mbrojtur me çdo kusht qytetin. Në mëngjesin e 27 tetorit 1880, Riza Pasha (kryekomandant i vilajetit të Shkodrës) nisi nga kampi ushtarak i Bardhokut, në jug të lumit Buna, 6 batalione osmane në drejtim të Ulqinit. Por forcat e Lidhjes Shqiptare në Kodrën e Shëngjergjit reagues me zjarr ndaj tyre dhe i detyruan të tërhiqeshin.

Ndërkohë, Porta e Lartë, vendosi të përfitonte nga përçarja që ndodhi në Kuvendin e Dibrës për t'i dhënë fund qëndresës së Ulqinit. Për këtë arsye, ajo emëroi komisar të jashtëzakonshëm dhe kryekomandant me fuqi të pakufizuara të vilajetit të

Shkodrës, mareshalin e ashpër Dervish Pasha, në vend të Riza Pashës, që u tregua i paaftë për të zbatuar me mjete politike vendimin e Fuqive të Mëdha. Kur Dervish Pasha mori detyrën, treva e Ulqinit ndodhej prej disa muajsh nën kontrollin e forcave vullnetare të Lidhjes Shqiptare. Shtabi i Mbrojtjes së Ulqinit kishte vendosur forcat vullnetare në 4 pika strategjike, nga mund të marshonin trupat osmane.⁵

1. Aradhja e parë prej disa luftëtarësh, nën komandën e ulqinakut Hysen Shazi, ishte vendosur në kodrat e Shëngjergjit. Përballë tyre, në fshatin Bardhok, komanda osmane kishte vendosur një kamp ushtarak, pasi kalonte rruga më e shkurtër që lidhte Shkodrën me Ulqinin.

2. Aradhja e dytë prej 1000 luftëtarësh (shkodranë, hotjanë, prizrenas, tetovarë, kelmendas etj.) të udhëhequr nga vetë Shtabi i Mbrojtjes, ku merrnin pjesë: Jusuf Sokoli, Mehmet Beci, Abdyl Hoti, Fetah Dragusha, Pjetër Çeka, Gjon Deda, Him Kastrati etj. ishin vendosur në Kodrën e Kuqe pranë fshatit Klesna me detyrë të zmbropste ekspeditën që mund të ndërmernte komanda osmane, nga kampi ushtarak, në fshatin Goricë, buzë rrugës së dytë që lidhte Shkodrën me Ulqinin.⁶

3. Aradhja e tretë prej disa qindra ulqinakësh, nën komandën e Mehmet Gjylit, ishte vendosur në malin e Mozhurës në VL të Ulqinit, një pozicion me rëndësi të dyfishtë strategjike, sepse këtu mund të përballohej jo vetëm marshimi nga lindja e trupave osmane (në rast se do të thyhej qëndresa në sektorin e Shëngjergjit apo të Klesnas), por edhe ndonjë sulm i mundshëm që mund të ndërmerrnin nga veriu forcat malazeze të përqëndruara në Tivar dhe Sutorman.

4. Aradhja e katërt, e përbërë nga vullnetarë ulqinakë, qëndronte brenda në Ulqin, ku mendohej të bëhej mbrojtja e fundit, ajo kishte edhe detyrën e rëndësishme për të mbajtur nën kontroll batalionin osman që nuk ishte larguar nga qyteti.

Numri i përgjithshëm i forcave vullnetare shqiptare të këtyre katër aradheve të përqëndruara në trevën e Ulqinit ishte rreth 3000 veta. Pra, në Ulqin fryma e qëndresës vazhdonte të ishte e lartë. Komiteti i Lidhjes në Ulqin mori masa mbrojtëse ndaj ekspeditës osmane, që dukej të ishte e afërt. Më 16 nëntor ai e përsëriti protestën që u kishte dërguar Fuqive të Mëdha më

24 tetor, 1880. Kjo vuri në lëvizje kancelaritë e vendeve europiane për të përdorur të gjitha mjetet në zgjidhjen e çështjes së Ulqinit në rrugë paqësore. Kështu, nën shantazhin e mareshalit Dervish Pasha dhe premtimeve të konsujve britanikë e austro-hungarezë se do të ndërhyjnë te sulltani për t'u dhënë shqiptarëve të drejta autonomiste, shumë anëtarë Komitetit Ndërkrahinor të Shkodrës deklaruan se hiqnin dorë nga qëndresa e armatosur në Ulqin. Kapitulluan edhe figurat më të njohura të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (LSHP) në Shkodër, si: Daut Boriçi, Hodo Sokoli etj., duke përfshirë edhe kapedanin e Mirditës, Prenk Bibë Dodën.

Kjo gjë shkaktoi protesta nga ana e qytetarëve shkodranë dhe ulqinakë, të cilët nuk i dorëzuan armët. Udhëheqësi i forcave ulqinake, Mehmet Gjyli dhe komandanti i vullnetarëve shkodranë, Isuf Sokoli, ripohuan edhe një herë vendosmërinë e tyre për ta mbrojtur me çdo kusht Ulqinin. Ky qëndrim e detyroi Dervish Pashën të vendoste shatoren e tij në mes të kampit në Bardhok.

Më 16 nëntor Dervish Pasha kishte në gadishmëri 20 batalione me rreth 10.000 trupa. Prej tyre: 8 batalione qenë vendosur në Bardhok, përballë pozicioneve shqiptare të kodrës së Shëngjergjit, 5 batalione në fshatin Goricë, përballë pozicioneve të forcave shqiptare në afërsi të Klesnas, 4 batalione në Shkodër, për të penguar nisjen e vullnetarëve të rinj dhe nga një batalion në Lezhë, Shëngjin dhe Ulqin.⁶

Kapitullimi i mjaft krerëve të Komitetit Ndërkrahinor ndikoi në pakësimin e forcave vullnetare të vendosura për mbrojtjen e Ulqinit. Më 18 nëntor 1880, kur filloi ekspedita, forcat e Lidhjes Shqiptare të përqëndruara në sektorin e Ulqinit, ishin rreth 3000 vullnetarë të vendosur në formacion luftimi në Shëngjergj, Klesna, Mozhure dhe Ulqin, kurse vullnetarët e tjerë qëndronin në shtëpitë e veta, pasi fondet e Komitetit për ushqimin ishin mbaruar prej kohësh. Veç kësaj, luftëtarët shqiptarë ishin inferiorë jo vetëm nga ana numerike, por edhe nga llojet e armatimeve dhe sasia e municioneve. Armiku i tyre kishte një artileri moderne, kurse forcat shqiptare ishin të pajisura me armë të vjetra dhe armatime të pakta.

Në situatën e krijuar, raporti forcave ishte 1:10 për

armikun (3000 vullnetarë shqiptarë përballë 30.000 trupave dhe 200 grykash zjarri artilerie. Përveç epërsisë në armatime e teknikë luftarake,⁷ vetëm trupat malazeze arrinin në 6000 veta, të mbështetura me 4 bateri artilerie në afërsi të malit Sutorman nga veriu. Ndërkaq, edhe flota detare e bashkuar e Fuqive të Mëdha numëronte 17 anije të mëdha luftarake me 138 topa dhe 7300 trupa të këmbësorisë detare, si dhe 22 batalione të ushtrisë osmane që mbanin të bllokuar të gjithë rajonin prej Lezhës deri në Shkodër.⁸

Më 16 nëntor 1880 forcat armike ishin gati për sulm. Sipas planit operativ paraprak, ato ishin të përqëndruara në dy kampe luftarake: në Bardhok 8 batalione (rreth 2000 trupa nën komandën e drejtpërdrejtë të Dervish Pashës) dhe në Goricë 4 batalione (rreth 2000 trupa nën komandën e Osman Pashës). Në mbështetje të ekspeditës qëndronte edhe një flotilje detare osmane dhe luftanija "Selimije" para ujërave të Ulqinit, gati për të bombarduar qytetin, sapo të jepte sinjalin komandanti i ekspeditës, si edhe dhe dy luftanije në grykën e Bunës, para skelës së Shënkollit, për të penguar lundrimin e vullnetarëve në rrugë detare për në Ulqin. Gjithashtu, Dervish Pasha solli nga Shkodra në brigjet e Shëngjergjit një numër barkash të shkodranëve për të ndërtuar mbi ta një urë të përkohshme për kalimin e trupave dhe të artilerisë nga Bardhoku në bregun e djathtë të Bunës.⁹

*

* *

Njëherazi mareshali turk e shtrëngoi darën e shtetrrethimit. Udhëtimi nga Shkodra për në Ulqin u ndalua rreptësisht. Në qytetin e Shkodrës u shumëfishuan patrullat luftarake. Në urat e Bahçallëkut dhe të Bunës u vendosën përforcime të reja ushtarake. Garnizoni i qytetit mori urdhër të zbatonte rreptësisht ligjin e luftës.

Shqiptarët, të zemëruar në kulm nga masat shtrënguese të Dervish Pashës, kundërvepruan me armë që më 16 nëntor. Atë ditë mareshali osman dërgoi nga kampi i Bardhokut përtej Bunës një batalion të përforcuar me dy topa, për të spastruar

Kodrën e Shëngjergjit nga forcat shqiptare. Vullnetarët e Lidhjes iu përgjigjën edhe një herë me armë, duke i detyruar forcat osmane të tërhiqeshin me shpejtësi. Pas tërheqjes, ato filluan nga kampi i Bardhokut rrahjen me artileri të pozicioneve shqiptare të Shëngjergjit. Më 20 nëntor në trevën e Ulqinit çdo gjë ishte gati për të përballuar sulmin e forcave osmane. Para se të fillonte operacionin kundër forcave vullnetare të Lidhjes, Dervish Pasha tërhoqi më 20 nëntor me luftanijen "Selimije" batalionin e bllokuar në qytet për veprime luftarake kundër ulqinakëve. Veprimet luftarake të ekspeditës osmane filluan furishëm më 21 nëntor 1880 në afërsi të kampit të Bardhokut. Rreth 4000 trupa, të mbështetura me artileri, kaluan urën e sapomontuar mbi Bunë dhe u ndeshën me forcat shqiptare të vendosura në pozicione luftimi në mbrojtje rrethore në kodrën e Shëngjergjit. Sipas raportit të kapitenit austriak Nanta, "batalionet osmane thyen shpejt qëndresën e shqiptarëve". Kjo ishte logjike në ato kushte të epërsisë së theksuar që kishin trupat osmane në forca dhe në mjete luftarake. Njëkohësisht, filloi marshimin nga kampi i Goricës edhe kolona e dytë osmane prej 1500 vetash, nën komandën e Osman Pashës, me drejtim për nga Kodra e Kuqe (pranë Klesnas). Këtu ishin vendosur forcat vullnetare nga Shkodra, Ulqini, Tetova, Shkreli, Dibra, Hoti e Kelmendi. Në Klesnas ndodhej edhe Shtabi Operativ i Mbrojtjes me bashkëkryetarët Jusuf Sokoli e Mehmet Beci në krye.

Ditën e parë të operacionit të dyja palët qëndruan në pritshmëri. Duket se komanda osmane donte t'u jepte kohë shqiptarëve që të grumbullonin forcat në Klesna për të dobësuar kështu vijën mbrojtëse të Mozhurës, me qëllim që të hapnin rrugën për në Ulqin. Por forcat shqiptare nuk pritën gjatë. Të nesërmen, me 22 nëntor filloi beteja me nismën operative të shqiptarëve. Sapo u dha sinjali i luftimit, forcat shqiptare dolën nga pozicionet dhe u hodhën me tërbim kundër tre batalioneve osmane. Pasi dhanë kundërgoditje e kundërsulme nga krahët dhe nga lart-poshtë, në shpat e kurriz, u arrit deri në luftime të ashpra trup me trup, ku shqiptarët treguan heroizëm të rrallë. Beteja zgjati 2 orë dhe qe tepër e "përgjakshme", njoftonte konsulli austrohungarez dhe shtonte se osmanët patën "humbje të mëdha" dhe lanë "shumë të vrarë". Sipas njoftimeve të

nesërme nga Shkodra, në luftime u shpartalluan 2 batalione nizamësh osmanë.

Siç del nga zhvillimi i këtij operacioni, shqiptarët shpalosën në betejë karakteristikat e një arti ushtarak original. Tiparin më të rëndësishëm të veprimeve luftarake të forcave vullnetare e përbënte morali i lartë luftarak, guximi dhe trimëria për t'u përballuar me armiq që kishin epërsi tepër të madhe në forca e në mjete, (me raportin 1:5 deri 1:10 për ta), shpirti sulmues dhe vendosmëria për të fituar. Shtabi operativ i kishte marrë të gjitha masat e nevojshme. Ai i kishte kushtuar vëmendje të veçantë organizimit të luftimit dhe shfrytëzimit mjeshhtëror të terrenit, të cilin vendasit e njihnin fort mirë.

Në përgjithësi, ai iu përmbajt rregullave të luftës ballore pozicionale aktive. Rreshtimin e forcave e kishte bërë në vija që vinin njëra pas tjetrës, të cilat krijonin thellësi në rendimin e luftimit dhe rritnin qëndrueshmërinë e mbrojtjes. Për këtë qëllim, shfrytëzoi edhe fortifikimet xhenerike të ndërtuara më parë nga ushtria osmane. Vetë ideja e luftimit parashikonte forma të ndryshme manovrash e dredhish luftarake, me qëllim që ta futnin armikun në kurth dhe ta asgjësonin atë pjesë-pjesë deri në shpartallimin e tij të plotë.

Osman Pasha, në pamundësi që të përballonte sulmin e shqiptarëve në këtë operacion kundërmësymës, u dha urdhër trupave të veta të tërhiqeshin në pozicione më të përshtatshme për to dhe përdori artilerinë, për të detyruar forcat shqiptare të linin Kodrën e Kuqe, por ato as që lëvizën nga pikëmbështetjet e tyre. Pikërisht në këtë situatë kritike për forcat e Osman Pashës, arriti në fushëbetë Dervish Pasha me një pjesë të trupave të veta, duke marrë në përforcim dy batalionet e vendosura në Shkodër dhe batalionin e tërhequr nga Ulqini. Pasi zëvendësoi repartet e dëmtuara të vijës së parë të luftimeve me forca të freskëta, ai ndërmoi po atë ditë kundërsulmin, me një ide të re taktike: të gjitha repartet dhe nënrepartet osmane të mësimit ballas e në mënyrë të mëvetësishme duke i goditur forcat shqiptare nga të gjitha anët për t'i çoroditur nga drejtimi kryesor.

Kundërsulmi dha rezultatet që priste Dervish Pasha, shqiptarët u mbrojtën heroikisht, por për shkak të epërsisë së madhe të armikut në forca dhe të municionit të pamjaftueshëm,

të mungesës së një komande të aftë për të drejtuar ushtarakisht dhe për shkak të plagosjes rëndë të Isuf Sokolit, ato u detyruan të tërhiqen për të mos u dëmtuar më shumë. Morën me vete gjithë të plagosurit bashkë me Isuf Sokolin, i cili vdiq disa orë më vonë nga plagët e rënda. Në këtë mënyrë, mori fund operacioni mbrojtës i Klesnas, i cili zgjati gjithsej 7 orë. Të dyja palët ndërluftuese patën mjaft të vrarë e të plagosur. Sipas zërave të përhapur ato ditë në Tivar, forcat osmane lanë në fushën e betejës 240 të vrarë dhe 50 të plagosur, ndërsa nga forcat shqiptare u vranë dhe u plagosën 23 veta.

Përgjithësisht, mbrojtja e Ulqinit u organizua në bazë pikëmbështetjesh me rajone luftarake të veçanta, të cilat ziheshin sipas rëndësisë, prej nënrepartesh dhe grupesh luftarake prej disa qindrash deri 1000 luftëtarësh. Në operacionet mbrojtëse të Ulqinit pati deri 4 pikëmbështetje të tilla. Luftimet mbrojtëse të shkallës taktike u karakterizuan nga dinamika e larmishme, nga manovra e veprimeve kundërgoditëse e kundërsulmuese për ndalimin e riparimin e forcave armike apo të marshimit të tyre për në objektiv, taktikë që u përshkrua më lart. Këto karakteristika të artit taktik, që spikatën në operacionet mbrojtëse të Ulqinit, ishin vijim dhe pasurim i mëtejshëm i parimeve të artit ushtarak shqiptar, që kishte lindur në zjarrin e luftimeve të zhvilluara deri atëherë nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit për mbrojtjen e trojeve shqiptare.

Pas përfundimit me disfatë të operacionit mbrojtës të Klesnas, të nesërmen, më 23 nëntor, 1880, forcat osmane vazhduan marshimin për në Ulqin. Në këtë drejtim, para tyre qëndronte si pengesë ende vija mbrojtëse në malin e Mozhurës. Prandaj, forcat marshuan përsëri në dy kolona: njëra ndoqi rrugën Shëngjergj-Ulqin, e cila, pasi kaloi malin e Brinjës, lëvizi drejt pikës, ku rruga tjetër e Shkodrës zbriste pranë fshatit Pistull në pjesën lindore të Mozhurës. Këtu ajo u ndesh me pararojat e forcave shqiptare. Tjetra ndoqi rrugën Klesna-Ulqin (rruga e dytë e Shkodrës) dhe doli në krahun verior të Mozhurës. Ndryshe nga sa parashikonte komanda osmane, forcat shqiptare në Mozhurë nuk bënë qëndresë, sepse, pas disfatës së Klesnas, vendosmëria e tyre ishte tronditur.

Megjithatë, përtej Mozhurës, në afërsi të Ulqinit, në

Kodër, shqiptarët që të gjithë ulqinakë, u dolën përpara forcave osmane e u përpoqën ta ndalonin marshimin e tyre, por pas dy orë luftimesh (sipas njoftimeve austrohungareze) apo 4 orë (sipas burimeve frënge) u thyen.

Pas këtyre humbjeve, forcat ulqinake krijuan bindjen se tashmë nuk ishin në gjendje ta përballonin epërsinë e armikut në trupa, armë e municione, aq më tepër kur humbën edhe shpresat për ndihma nga krahina të tjera, prandaj u detyruan të heqin dorë nga qëndresa e mëtejshme dhe më 24 nëntor, 1880 i dorëzuan armët. Si pasojë, më 28 nëntor, 1880 Ulqini iu dorëzua nga Porta e Lartë forcave malazeze.

Kështu, pas tri ditë luftimesh të ashpra mbrojtëse, mori fund me dhembje të thellë për shqiptarët çështja e Ulqinit, e cila, sikurse vinte në dukje ato ditë konsulli austrohungarez Lippih, “mbajti në gjendje alarmi për 4 muaj me radhë Europën...”.¹⁰

Pasi Ulqini iu dorëzua trupave malazeze, me qindra familje ulqinake morën rrugën e mërgimit. Pjesa më e madhe shkuan në drejtim të Shkodrës, Shëngjinit e Durrësit. Me dhjetëra anije tregtare ulqinake u vendosën në bregdetin shqiptar.

Ky ishte dhe përfundimi tragjik i Ulqinit shqiptar. Por nga qëndresa e armatosur që bënë shqiptarët, opinionin ndërkombëtar u bind se treva e Ulqinit nuk ishte një krahinë malazeze dhe se Fuqitë e Mëdha ia kishin dhënë atë padrejtësisht Malit të Zi.

¹ Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, f. 1132.

² Vojna Enciklopedija (Enciklopedia jugosllave), Beograd, 1975, vëll. 10, f. 222.

³ K. Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881), Tiranë, 1997, f. 312.

⁴ AKTE/RKSH, f. 117.

⁵ K. Frashëri, po aty, f. 341.

⁶ K. Frashëri, po aty, f. 347.

⁷ Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, f. 686.

⁸ Akademia ushtarake “Spiro Moisiu”, Historia e Artit Ushtarak të popullit shqiptar prej rendit skllavopronar deri më 1939, vëll. II, Tiranë, 1989, f. 398-400.

⁹ K. Frashëri, po aty, f. 349.

¹⁰ K. Frashëri, po aty, f. 354, 355.